

## **FTESE PER MEDIAT DHE OJF-TE**

### **ÇMIMI I GAZETARISE PER TE DREJTAT E FEMIJEVE 2006**

**Financuar nga: Olof Palme International Centre dhe SIDA**

E / I nderuar Zonje / Zoteri,

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) dhe Qendra e Informacionit dhe Kerkimeve për të Drejtat e Femijeve në Shqipëri (IRCCRA), kanë kenaqesine që të njoftojne se në muajin Dhjetor 2006, për here të dyte në Shqipëri, do të japin **Çmimin e Gazetarise për të Drejtat e Femijeve në Shqipëri**.

Për të inkurajuar një pjesmarrje të drejte dhe të gjere të të gjithë gazetareve në Shqipëri, CRCA dhe IRCCRA do të shpallin në fund të vitit 2006, tre Çmime të Gazetarise, si më poshte:

- 1. Çmimi i Gazetarit ose Gazetares për të Drejtat e Femijeve në median e shkruar.**
- 2. Çmimi i Gazetarit ose Gazetares për të Drejtat e Femijeve në Radio.**
- 3. Çmimi i Gazetarit ose Gazetares për të Drejtat e Femijeve në Televizion.**

**Qellimi i Çmimit**

Çmimi i Gazetarise per te Drejtat e Femijeve ka si qellim qe:

- Te promovojë çështjen e te drejtave te femijeve ne median e Shkruar, Radiofonike dhe Televizive;
- Te permiresojë cilesine e raportimit dhe prezantimit te çështjes se femijeve dhe te te drejtave te tyre;
- Te rrisë zbatimin e Etikes Profesionale e Gazetarit ne mbrojtjen e femijeve nga etiketimi, viktimizimi, publikimi i te dhenave personale per femijet etj.

### **Kush mund te aplikojë**

Jane te ftuar te aplikojne per **Çmimin e Gazetarise per te Drejtat e Femijeve ne Shqiperi** te gjithë gazetaret e medias se shkruar, Radios dhe Televizionit qe punojne dhe shperndajne informacionin e tyre ne Shqiperi.

**OJF-te dhe organizatat e shoqerise civile kane te drejte te nominojne gazetare per kete çmim, por duke derguar te plotesuar dhe derguar prane CRCA Formen e Nominimit dhe arsyet e nje nominimi te tille.**

### **Formati i Aplikimit dhe Kriteret**

**Per median e shkruar:** Komisioni i Vleresimit do te pranoje Artikuj, Reportazhe dhe Raporte, te cilat jane botuar per femijet dhe te drejtat e tyre ne Shqiperi gjate vitit 2006 ne Gazeta dhe Revista ose botime te tjera alternative. Nuk do te pranohen shkrime qe nuk jane botuar, ose intervista dhe lajme te shkurtra. Te gjithë te interesuarit duhet te paraqesin nje kopje origjinale ose fotokopje te Artikullit, Reportazhit ose Raportit, ashtu sic eshte botuar ne Gazete, Reviste etj, duke perfshire edhe ditën e botimit.

**Per Radion:** Komisioni i Vleresimit do te pranoje Raporte te Lajmeve, Reportazhe ose Programe Radiofonike, te cilat jane transmetuar ne Shqiperi per femijet dhe te drejtat e tyre gjate vitit 2006 ne Radio. Nuk do te pranohen lajme / raporte qe nuk jane transmetuar, ose intervista dhe lajme me te shkurtra se 30 sekonda. Te gjithë te interesuarit duhet te paraqesin nje kopje ne Kasete ose DVD te Lajmit / Reportazhit / Programit (preferohet DVD), ashtu sic eshte transmetuar ne Radio, duke perfshire oren dhe ditën e transmetimit.

**Per Televizionin:** Komisioni i Vleresimit do te pranoje Lajme, Reportazhe ose Programe Televizive, te cilat jane transmetuar per femijet dhe te drejtat e tyre ne Shqiperi gjate vitit 2006 ne Televizion. Nuk do te pranohen raporte qe nuk jane transmetuar, ose intervista dhe lajme me te shkurtra se 30 sekonda. Te gjithë te interesuarit duhet te paraqesin nje kopje ne VHS ose DVD te Lajmit / Reportazhit / Programit (preferohet DVD), ashtu sic eshte transmetuar ne Televizion, duke perfshire oren dhe ditën e transmetimit.

## Dergimi i Materialeve

**Te gjitha materialet duhet te sillen te mbyllura ne zarf prane zyrrave te CRCA brenda dates 15 Dhjetor 2006, ndermjet ores 09.30 – 17.00.** Materialet mund dergohen edhe me poste brenda dates 10 Dhjetor 2006. Ne pjesen e siperme te zarfit duhet shkruar Emri i Aplikantit / Aplikantes dhe subjekti “Per Çmimet e Gazetarise”, ndersa brenda zarfit cdo aplikant duhet te shkruaje nje leter ku te specifikojte kategorine per te cilen aplikon (Media e Shkruar, Radio, Televizion) si dhe per efekt te kontaktit emrin dhe mbiemrin, adresen, numrin e telefonit, e-mail, si dhe emrin e Gazetes, Radios dhe Televizionit per te cilen punojne.

## Perzgjedhja dhe Shpallja e Çmimeve

Perzgjedhja e Çmimeve do te behet nga nje Komision Vleresimi, pjese e te cilit do te jene drejtues te OJF-ve qe punojne per te drejtat e femijeve ne Shqiperi, njerez te njohur te medias dhe femije. Per arsye te nje vleresimi sa me objektiv emrat e anetareve te Komisionit nuk do te behen publike.

**Çmimet e Gazetarise do te shpallen ndermjet Dates 20 – 30 Dhjetor 2006 ne nje Njoftim per Shtyp, qe do te behet publik per te gjitha te interesuarit.**

CRCA dhe IRCCRA do te organizojne nje Ceremoni Zyrtare Prezantimi per te tre fituesit e Çmimit te Gazetarise, per t'i dhene Çmimet si dhe bere te njohur perpara opinionit te gjere publik, medias, OJF-ve etj. CRCA nuk eshte e detyruar qe te njoftoje jo-fituesit apo te jape shpjegime per dhenien e Çmimeve.

\*

\*

\*

## Kush eshte CRCA

Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi – CRCA eshte nje nga organizatat kryesore ne Shqiperi qe punon per mbrojtjen e te drejtave te femijeve ne Shqiperi, zhvillimin e femijes dhe rritjen e pjesmarrjes se femijeve ne nivel lokal dhe qendror, nepermjet forcimit te politikave, legjislacionit dhe sherbimeve per femijet. Puna e CRCA eshte fokusuar ne ndihme te te gjitha femijeve te marginalizuar, si dhe te gjitha femijeve qe iu shkelen te drejtat. Ne sot ndihmojme me sherbime femijet qe punojne, femijet e trafikuar, femijet e rruges, femijet ne komisariate, dhoma paraburgimi dhe burgje, femijet qe braktisin shkollen, femijet e abuzuar etj.

CRCA eshte krijuar ne Mars 1997, me synim zbatimin e Konventes per te Drejtat e Femijeve te OKB-se. Shtate vjet me vone CRCA eshte nje nga organizatat kombetare me te rendesishme ne Shqiperi dhe Europen Juglindore per te drejtat e femijes. CRCA eshte anetare e Defence for Children International, nje organizate nderkombetare prezente ne mbi 30 vende te Botes, me zyra ne Gjeneve, si dhe e shume rrjeteve nderkombetare per te drejtat e femijeve dhe te drejtat e njeriut ne Europe.

